



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr.01

Prishtinë, më 6.10.2017, në ora:11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Shqipe Pantina, Jasmina Zivkovic, Valon Ramadani, Fisnik Ismaili, Imet Rrahmani, Xhevahire Izmaqi, Rasim Selmanaj, Milaim Zeka dhe Albert Kinolli.

Mungoi: Arban Abrashi.

Në mbledhje morën pjesë:

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Nait Hasani, kryetar i Komisionit, me këtë rend të ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Konstituimi i komisionit;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Konstituimi i komisionit

Kryetari i komisionit, i njoftoi anëtarët e komisionit se komisioni është formuar sipas vendimit të Kuvendit të Kosovës, dt. 3 tetor 2017, nr. 06-V-006. Ai kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen për kohën dhe ditën e rregullt të mbajtjes së mbledhjeve, me qëllim që anëtarët e komisionit, të cilët janë anëtarë edhe në komisionet tjera, të koordinojnë kohën për pjesëmarrje në mbledhje.

Konstatim: Të gjithë anëtarët e komisionit u pajtuan që orari i rregullt i mbledhjes të jetë çdo të mërkurë, në ora 10:00.

3. Të ndryshme

Kryetari i komisionit, i njoftoi anëtarët e komisionit edhe për çështjet si në vijim:

- Lidhur me plotësim-ndryshimin e Ligjit për RTK-në dhe Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, të hartuar nga komisioni i legjislaturës së kaluar, çështja kthehet që nga fillimi dhe komisioni do të rifillojë iniciativën, posa të hartojë planin e punës së komisionit.
- Komisioni kërkoi nga zyra koordinuese e komisionit, të hartojë draft-planin e punës së komisionit, sipas programit të Qeverisë për vitin 2017, legjislatura e gjashtë, në mënyrë që në mbledhjen e radhës të prezantohet para komisionit për shqyrtim dhe miratim.
- Komisioni shqyrtoi shkresën e Komisionit të Pavarur për Media, lidhur me emërimin e një anëtari në Bordin për Ankesa të Mediave dhe një anëtari në Komisionin e Pavarur për Media. Lidhur me këtë, komisioni propozoi që kjo çështje të shtyhet deri në vendosjen nga Kryesia e Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën: 12:00.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani